




REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 03-02/DPK	Nr Prot 01-1743/16
Dep. 03	B. Prot Prot No
Nr. i faq	Data 13.05.2016
Broj stranica	Data
Nr. pages	
www.SHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.05.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-1243/16 për z. Shefqet Rexha – Ish Udhëheqës i Personelit në Komunën e Kamenicës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti është hapur pas një informacioni të deponuar në Agjencinë kundër Korrupsionit, nën dyshimin për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-1243/16, në lidhje me një proces të punësimit, për të cilin është pretenduar se znj. Filloreta Rexha, e punësuar në vendin e punës Sekretare në QKMF-në e Kamenicës ka pas konflikt interesi, pasi që burri i saj ztr. Shefqet Rexha, në atë kohë ka ushtruar pozitën e Udhëheqësit të personelit në Komunën e Kamenicës.

Ne lidhje me këtë rast, Agjencia kundër Korrupsionit, ka aranzhuar takim me ztr. Avni Hoda Menaxher i Zyrës ligjore në Komunën e Kamenicës, dhe njëkohësisht Kryetar i Komisionit të pranimit.

Nga biseda me te, dhe nga shkresat e lëndës, kemi konstatuar se Vendimin për hapjen e vendit të punës, për formimin e komisionit të vlerësimit, e merr Kryetari i Komunës. Po ashtu, ztr. Shefqet Rexha (bashkëshorti i znj. Filloreta Rexha e pranuar pastaj në këtë pozitë), nuk ka qenë as pjesë e komisionit të vlerësimit e as që ka pas rol aktiv në këtë aktivitet.

Prandaj, nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar dyshimi për konflikt interesi. Në fakt, për dikën mund të jetë vetëm konflikt në dukje i interesit, por jo konflikt faktik.

III. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Hasan Preteni /